



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONI I MBROJTJES SË KONSUMATORËVE**

---

**VENDIM**

**Nr. 22, Datë 22.02.2012**

Komisioni i Mbrojtjes së Konsumatorëve me pjesëmarrjen e:

- Znj. Anila Jani Kryetar
- Z. Gerdjan Xhanari Nënkryetar
- Znj. Marsida Xhaferllari Anëtar
- Z. Altin Goxhaj Anëtar
- Z. Zamir Moçka (Stefani) Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 22.02.2012, vazhdoi shqyrtimin e ankesës se ardhur nga Korab Halilaj, ne lidhje me praktikën e ndjekur nga Ndërmarrja e Trajtimit të Studenteve sh.a, Shkodër, ne rastet kur studentet kanë kryer parapagimin e tarifës se qirasë vjetore dhe kur studenti vendos për të mos përmbushur kontratën e qerasese.

Komisioni pas shqyrtimit të ankesës se sipërpërmendur,

**VËREN SE:**

Shqyrtimi i kësaj ankese ka filluar ne mbledhjen e datës 27.01.2012 dhe, për një vlerësim te plote te kësaj çështjeje, Komisioni me shkrese nr. prot 45, date 31.01.2012, i ka kërkuar Ndërmarrjes se Trajtimit te Studenteve sh.a, Shkodër, informacion ne lidhje me ankesën e Korab Halilaj (bashkëlidhur shkrese ne fjale) si dhe një kopje te kontratës tip te qirasë midis Trajtimit te Studenteve Shkodër dhe studentëve.

Komisioni konstaton se, Ndërmarrja e Trajtimit te Studenteve sh.a, Shkodër, nuk ka dhënë ende asnjë informacion.

Komisioni konstaton se, ne vijim te shkresës nr. prot 45, date 31.01.2012, Ndërmarrja e Trajtimit te Studenteve sh.a, Shkodër ka kryer shkelje te nenit 52/1 te ligjit nr.9902, date 17.04.2008 “Për mbrojtjen e konsumatorëve”, i ndryshuar, sipas te cilit:

*“ Tregtaret janë te detyruar te japin ne mënyre te qarte, te vërtete dhe jo te mangët, të gjithë informacionin e kërkuar nga organet zbatuese dhe struktura përgjegjëse për mbrojtjen e konsumatorëve, sipas dispozitave te këtij ligji”*

## PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Mbrojtjes së Konsumatorëve mbështetur ne nenin 52/1; shkronjën “d”, pika 2, neni 57 te Ligjit nr. 9902, date 17.04.2008 “Për mbrojtjen e konsumatorëve”, i ndryshuar, si dhe ne shkronjën “c”, pika 6 të VKM nr. 1444, datë 22.10.2008 “Për mënyrën e funksionimit e te pagesës se anëtareve te komisionit te mbrojtjes se konsumatorëve, si dhe përcaktimin e procedurave te vlerësimit te shkeljeve” .

## VENDOSI:

1. Ndërmarrja e Trajtimit te Studenteve sh.a, Shkodër, te gjobitet ne masën 300 000 leke.
2. Ndërmarrja e Trajtimit te Studenteve sh.a, Shkodër te njoftoje menjëherë, Komisionin e Mbrojtjes se Konsumatorëve, për pagesën e gjobës brenda 15 ditësh nga marrja e njoftimit te këtij Vendimi.

Kundër Vendimit te Komisionit te Mbrojtjes se Konsumatorit, keni te drejte te ankoheni në Gjykatë, brenda 30 ditëve nga data e marrjes dijeni për vendimin.

**KRYETAR I KOMISIONIT**

